



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 170

Tiranë – E martë, 2 nëntor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13301, datë 28.10.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	15317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 642, datë 29.10.2021	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.....	15317
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 643, datë 29.10.2021	Për emërim në detyrë.....	15321
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 29.10.2021	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.....	15321
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 4.10.2021	Me objekt shfuqizimin e pikës 1, të nenit 162, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	15322
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 14.10.2021	Kërkesat nr. 13514/16 dhe 52735/20, Sokol Sheti kundër Shqipërisë dhe Merita Gjashta kundër Shqipërisë.....	15335
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 14.10.2021	Kërkesa nr. 26512/12, Ilir Beqja kundër Shqipërisë.....	15337
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 207, datë 8.10.2021	Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Votalia” s.a. dhe OST sh.a., për vlerësimin dhe pranimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen standarde të lidhjes, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018.....	15337
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 208, datë 8.10.2021	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores, mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji, për arritjen e treguesve të matjes dhe të vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit.....	15339

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 209, datë 8.10.2021	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Terfoja”, me kapacitet të instaluar 1980 kw.....	15340
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 210, datë 8.10.2021	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.....	15342
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 211, datë 8.10.2021	Mbi përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës me nr. 85, seria PV09K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Pure Energy Stebleva” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.8.2009.....	15344
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 212, datë 8.10.2021	Mbi miratimin e kërkesës së subjektit “Depa Commercial” s.a. për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg – testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen.....	15345

**DEKRET**

Nr. 13301, datë 28.10.2021

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 6, 8, 20 e 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Bujar Ismet Lahu
2. Artan Hamdi Rexhepi
3. Alexandre Charles Nicolas Thierry Felix Gustave Debussy
4. Toni Gazmend Roka
5. Krenar Gazmend Roka
6. Özay Celal Kaloç
7. Egemen Halil Bahadır Gökyaran
8. Lusha Nrec Markaj (Gjini)
9. Nasuf Sefedin Jakupi
10. Leonida Bashkim Petku (Hajdaraj)
11. Danilo Umberto Astori
12. Antigona Gjemail Selimi (Xhurkaj)
13. Samile Gjemail Nimani (Bajraktari)
14. Luljeta Ndue Mirdita
15. Altina Shefi Marinaj (Cenka)
16. Şahan Mehmet Nazif Ülgen
17. Bedriye Mehmet Sürücü (Kuşuş)
18. Behar Daut Kasabaj
19. Eric Aban Ludovino Layno
20. Hussam El Din Arfan Tarabichi
21. Mehmet Irfan Zirek
22. Mohamad Ali Jawhar
23. Giuseppe Carmelo Antonino Monforte
24. Donika Abdurrahmon Jegeni (Zhubi)
25. Arton Beqir Morina
26. Besnik Mehmet Çarri
27. Elmedina Fatmir Hasani
28. Kastriot Bedri Haxhosaj
29. Ramë Beqir Morina
30. Amantina Ilir Dobi (Tolaj)
31. Zsuzsanna György Sulejmani (Bednâr)
32. Pashuk Pashk Ndue
33. Nazmi Rexhep Tahiri

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM

Nr. 642, datë 29.10.2021

**PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
SHTETËRORE TË PROGRAMIMIT
STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT
TË NDIHMËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 e 18, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, e njohur edhe si *State Agency for Strategic Programming and Aid Coordination*, (këtu e në vijim SASPAC-ja), si person juridik publik buxhetor, në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë.

2. SASPAC-ja e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe organizohet në nivel qendror.

3. SASPAC-ja financohet nga buxheti i shtetit, donacione dhe nga burime të tjera të ligjshme.

4. SASPAC-ja ka si mision koordinimin e ndihmës së huaj për programet dhe projektet zhvillimore, asistimin e strukturave vendimmarrëse për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI) dhe monitorimin e zbatimit të saj, ofrimin e mbështetjes metodologjike në hartimin e strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale, me qëllim harmonizimin e tyre me SKZHI-në, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre, koordinimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar, ofrimin e



mbështetjes për institucionet e administratës shtetërore për rritjen e kapaciteteve në fushën programeve dhe projekteve zhvillimore.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE TË SASPAC-së

SASPAC-ja ka si përgjegjësi funksionale të organizojë punën:

a) për të siguruar, në bashkëpunim me komunitetin e donatorëve dhe institucionet shtetërore, koordinimin e ndihmës së huaj për programet dhe projektet zhvillimore, në funksion të realizimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

b) për të siguruar koordinimin e programeve kombëtare dhe rajonale të asistencës financiare të BE-së, monitorimin e zbatimit të tyre, si dhe për të mbështetur punën e Koordinatorit Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian (KKIPA);

c) për të asistuar institucionet përkatëse vendimmarrëse, përgjegjëse për planifikimin strategjik, në funksion të hartimit të SKZHI-së dhe për të ofruar mbështetje metodologjike për strukturat përkatëse që kanë detyrën e hartimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale në harmonizim me SKZHI-në, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë;

ç) për të monitoruar zbatimin e SKZHI-së dhe strategjive të tjera sektoriale e ndërsektoriale;

d) për të siguruar mbështetje për institucionet e administratës shtetërore dhe për misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për përfundimin e financimeve të programeve të ndryshme zhvillimore;

dh) për të siguruar mbështetje për strukturat vendimmarrëse, lidhur me projektet me rëndësi kombëtare dhe, në koordinim me ministrinë përgjegjëse për financat, të përcaktohen mekanizmat financiarë të nevojshëm dhe sigurohet mbështetje e nevojshme financiare për këto projekte nga donatorët;

e) për të siguruar mbështetje për institucionet e administratës shtetërore, për hartimin e projekteve të ndryshme dhe zbatimin efektiv të projekteve të miratuara.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SASPAC-së

1. SASPAC-ja drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili përgjigjet para Kryeministrit dhe

përfaqëson SASPAC-në në marrëdhënie me të tretët.

2. Drejtori i Përgjithshëm i SASPAC-së emërohet, lirohet apo shkarkohet nga detyra nga Kryeministri. Drejtori i Përgjithshëm i SASPAC-së duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në shkenca sociale, inxhinierike, juridike, ekonomike;

ç) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet, ku 7 prej tyre në fushën e ekspertizës dhe/apo të administrimit publik;

d) të dallohet për aftësi profesionale dhe cilësi të larta etiko-morale;

dh) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

e) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi.

3. Drejtori i Përgjithshëm i SASPAC-së kryen detyrën e Koordinatorit Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian (KKIPA).

4. Drejtori i Përgjithshëm i SASPAC-së lirohet ose shkarkohet nga detyra kur:

a) mbush moshën e pensionit;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën;

ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;

d) jep dorëheqjen;

dh) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës.

5. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe punonjësve administrativë të SASPAC-së rregullohen në bazë të Kodit të Punës. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të SASPAC-së rregullohen në bazë të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

6. Struktura dhe organika e SASPAC-së hartohen në përputhje me përgjegjësitë funksionale



të parashikuara në këtë vendim dhe miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

7. Strukturat përgjegjëse të projekteve pranë institucioneve të administratës shtetërore bashkërendojnë punën e tyre me SASPAC-në. Këto struktura informojnë periodikisht dhe sipas kërkesës pranë SASPAC-së, sipas formatit të miratuar nga drejtori i Përgjithshëm i SASPAC-së.

8. SASPAC-ja koordinon punën me Zyrtarin Kombëtar Autorizues dhe strukturat përgjegjëse të menaxhimit pranë tij, Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe donatorëve të tjerë. Formatit dhe procedura e mbështetjes dhe koordinimit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

9. SASPAC-ja mbështet ministrinë përgjegjëse për Evropën në përmbushjen e përgjegjësisë të saj për procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe misionet diplomatike në koordinimin e punës së tyre me donatorët e huaj. Formatit dhe procedura e mbështetjes dhe koordinimit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

10. SASPAC-ja mbështet Kryenegociatorin dhe grupin negociator në programimin dhe monitorimin e asistencës financiare të BE-së në funksion të procesit të aderimit në BE dhe të zbatimit të marrëveshjes së stabilizim-asociimit. Formatit dhe procedura e mbështetjes dhe koordinimit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

11. SASPAC-ja bashkërendon punën për funksionimin e grupeve të menaxhimit të integruar të politikave (GMIP), në përputhje me përcaktimet e urdhrit të Kryeministrit që përcakton masat për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial dhe ndërsektorial të integruar, me qëllim përmirësimin e dialogut mbi politikat në të gjithë sektorët e GMIP-ve dhe rritjen e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së këtij mekanizmi koordinues.

12. SASPAC-ja, në përputhje me përgjegjësitë e veta, kryen këto detyra:

a) në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat dhe komunitetin e donatorëve koordinon ndihmën e huaj që merr Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë për programe dhe projekte

zhvillimore, në funksion të realizimit të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet;

b) në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë, koordinon programet kombëtare, ndërkufitare, rajonale apo çdo formë tjetër të asistencës financiare të BE-së dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

c) mbështet Kryeministrin dhe çdo strukturë përgjegjëse politikëbërëse, në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë, për përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të vendit dhe hartimin e prioriteteve të qeverisë, si dhe identifikon programet e rëndësisë kombëtare;

ç) ndihmon strukturat vendimmarrëse në procesin e hartimit të SKZHI-së dhe ofron mbështetje metodologjike në procesin e hartimit nga ana e institucioneve përgjegjëse të strategjive të ndryshme sektoriale e ndërsektoriale, në përputhje me SKZHI-në, si dhe monitoron zbatimin e tyre;

d) në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe strukturat e projekteve të institucioneve të administratës shtetërore, bashkërendon hapat e nevojshëm për të siguruar nga ana e tyre zbatimin efektiv të projekteve të miratuara nga organet vendimmarrëse përkatëse, sipas marrëveshjeve financiare dypalëshe e shumëpalëshe me donatorët;

dh) koordinon, në bashkëpunim me institucionet shtetërore, përcaktimin e nevojave të tyre për mbështetje financiare nga donatorët;

e) evidenton detyrimet apo nevojat që burojnë nga zbatimi i SKZHI-së dhe strategjive sektoriale e ndërsektoriale, dhe mbështet ministrinë përgjegjëse për financat dhe/ose institucionet e tjera përgjegjëse, në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë, gjatë procesit të hartimit të kornizës së buxhetimit afatmesëm dhe të tavanëve buxhetore, për këtë qëllim;

ë) siguron mbështetje për funksionimin e njësisë të zbatimit të projekteve me financim të huaj (PIU/PMU etj.) të institucioneve të administratës shtetërore;

f) administron bazat e të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH) dhe Sistemin Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI), si dhe parashikon kërkesat funksionale dhe propozon ndryshime, në varësi të nevojës së mirëfunksionimit dhe përmirësimit të këtyre sistemeve elektronike;



g) në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financat, siguron funksionimin e mekanizmave të mbështetjes financiare, për kryerjen e pagesave të komisioneve financiare për pjesëmarrje të programeve të ndryshme me financim të huaj, për rimbursimin e detyrimeve fiskale të projekteve me financim të huaj, si dhe për kryerjen e pagesave fillestare dhe/ose bashkëpagesave të institucioneve të ndryshme në projekte të ndryshme me financim të huaj;

gj) ofron mbështetje profesionale për misionet diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për përfundimin e financimeve të programeve të ndryshme zhvillimore;

h) sipas kërkesës, ofron mbështetje financiare dhe profesionale për institucione të administratës shtetërore në hartimin e projekteve të ndryshme, vlerësimin e rezultateve të projekteve, në funksion të rritjes së përfitimeve të financimeve të programeve të ndryshme zhvillimore dhe zbatimit të tyre me eficiencë të lartë;

i) harton dhe administron regjistrat:

i. për projektet me rëndësi kombëtare;

ii. e personave të autorizuar për menaxhimin e projekteve me financim të huaj.

j) kryen detyrën e Sekretariatit Teknik për Komitetin e Planifikimit Strategjik;

k) mban kontaktet e nevojshme me strukturat homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe nënshkruan protokolle bashkëpunimi me ta;

l) mundëson edukimin dhe informimin e subjekteve të interesuara në lidhje me instrumentet financiare të ndihmës së huaj, si dhe mjetet e mundshme të ndihmës së huaj që do të mund të rrisin mundësinë e entiteteve shqiptare, publike apo private, përfshirë individët, për të pasur akses të suksesshëm të fondeve të ndihmës së huaj;

ll) raporton periodikisht te Kryeministri mbi veprimtarinë e saj, si dhe sa herë kërkohet prej Kryeministrit, bazuar edhe në informacionet e siguruar nga strukturat përgjegjëse të projekteve pranë institucioneve të administratës shtetërore, sipas parashikimit të pikës 7, të kreut III, të këtij vendimi;

m) informon periodikisht ministrin përgjegjës për financat, ministrin përgjegjës për Evropën, ministrin përgjegjës për punët e jashtme, komunitetin e donatorëve dhe institucione të tjera shtetërore, sipas kërkesës, mbi veprimtarinë e SASPAC-së;

n) kryen çdo detyrë tjetër të caktuar nga Kryeministri, Këshilli i Ministrave apo legjislacioni në fuqi.

13. Rregullorja, që përcakton metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të SASPAC-së, miratohet nga Kryeministri, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm.

14. SASPAC-ja ka stemën, logon dhe vulën e saj zyrtare. Stema e SASPAC-së përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Kryeministria, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Bashkërendimit të Ndihmës”, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

15. Vula e SASPAC-së ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Drejtori i Përgjithshëm i SASPAC-së emërohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Deri në plotësimin e strukturës së SASPAC-së dhe në caktimin e selisë së saj, drejtori i Përgjithshëm do të mbështetet në detyrat e tij nga nëpunësit e Kryeministrit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Njësitë përkatëse të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri, Sektori i Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj (në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj) në ministrinë përgjegjëse për financat, Drejtoria e Bashkëpunimit Territorial dhe Drejtoria e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s në ministrinë përgjegjëse për Evropën rristrohen në strukturën dhe organikën e SASPAC-së.

4. Për nëpunësit e njërive të përcaktuara në pikën 3, të këtij kreu, zbatohen dispozitat e legjislacionit të nëpunësit civil në rastin e mbylljes dhe rristrukturimit të institucionit.

5. Shpenzimet për strukturat e përmendura në pikën 3, të kreut IV, të cilat do të rristrukturohen në strukturën dhe organikën e SASPAC-së, kryhen nga institucionet në të cilat ndodhen aktualisht, deri



në ndryshimin e ligjit të buxhetit të vitit 2021. Efektet financiare shtesë të SASPAC-së, për vitin 2021, përballohen nga buxheti i Kryeministrit.

6. Pika 3, e kreut III, zbatohet pas hyrjes në fuqi të aktit që shfuqizon pjesën e parë të pikës 2, të kreut II, të vendimit nr. 422, datë 6.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

7. Shkronja “P”, e pikës 12, të kreut III, zbatohet pas hyrjes në fuqi të aktit që ndryshon vendimin nr. 590, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Ndihmës së Huaj (SIMNH)” dhe të vendimit nr. 290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)”.

8. Aktet e tjera të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të zbatohen derisa nuk janë shfuqizuar.

9. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 643, datë 29.10.2021

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Almira Xhembulla emërohet zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 645, datë 29.10.2021

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR MINISTRINË E MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve për shpenzime korrente, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) në programin 07340 “Mbështetja shëndetësore”, të shtohet fondi 107 600 000 (njëqind e shtatë milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

b) në programin 09430 “Arsimimi ushtarak”, të shtohet fondi 62 000 000 (gjashtëdhjetë e dy milionë) lekë;

c) në programin 02120 “Forcat e luftimit”, të pakësohet fondi 143 200 000 (njëqind e dyzet e tre milionë e dyqind mijë) lekë;

ç) në programin 10910 “Emergjencat civile”, të pakësohet fondi 26 400 000 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind mijë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 31, datë 4.10.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha,	kryetare;
Elsa Toska,	anëtare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj,	anëtar;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Përparim Kalo,	anëtar,

me sekretare Enina Kotoni, në datën 28.9.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 3 (E) 2021 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Elton Debreshi, përfaqësuar nga avokat Gentian Sejrani, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Mimoza Arbi, me autorizim; Avokati i Popullit, Erinda Ballanca, e paraqitur personalisht në gjykim; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda, i paraqitur personalisht në gjykim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i pikës 1, të nenit 162, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 1, pika 3, 3, 18, pikat 1 dhe 2, 45, pikat 1 dhe 4, 124, 131, pika 1, shkronja “a” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe neni 3 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Përparim Kalo, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili kërkonte pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjektit të interesuar, Kuvendin të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), që kërkonte rrëzimin e kërkesës, mendimet

e subjekteve të interesuara, Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me dekretin nr. 11700, datë 6.9.2020, Presidenti i Republikës ka caktuar ditën e diel 25.4.2021 si datë për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

2. Me vendimin nr. 63, datë 11.2.2021, në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Kodi Zgjedhor), Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ka regjistruar komitetin nismëtar për organizimin e punës për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për z. Elton Lahim Debreshi, si subjekt zgjedhor “kandidat i propozuar nga zgjedhësit” në zonën zgjedhore qarku Dibër.

3. Me shkresën nr. 1018/2 prot., datë 24.2.2021, komiteti nismëtar ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nënshkrimet mbështetëse të 1,350 zgjedhësve të përfshirë në ekstraktin e përbërësve zgjedhorë në zonën zgjedhore qarku Dibër, si dhe dokumentacionin përkatës.

4. Me vendimin nr. 118, datë 8.3.2021, KSHZ-ja, pasi ka verifikuar dokumentacionin dhe ka konstatuar se ishte në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 69, 72 e 73, të Kodit Zgjedhor, e ka regjistruar kërkuarin si kandidat të propozuar nga zgjedhësit për deputet në Kuvend në zonën zgjedhore qarku Dibër.

5. Në datën 13.4.2021 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të pikës 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor, që ka këtë përmbajtje: “1. Jo më vonë se 3 ditë nga përfundimi i procesit të ankimit kundër vendimit për miratimin e rezultateve të zonës zgjedhore apo pavarësisht mbarimit të zgjedhjeve, sipas këtij Kodi, KQZ-ja përlogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e numrit të votave të vlefshme që subjektet kanë marrë në nivel zone zgjedhore. Për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve



subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.”.

6. Me vendimin e datës 29.4.2021, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kësaj çështjeje për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 21.5.2021, ka vendosur ta kalojë atë për shqyrtim në seancë plenare publike.

7. Në datën 25.4.2021 janë zhvilluar zgjedhjet për Kuvendin, ku kërkuesi ka marrë pjesë si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore qarku Dibër.

8. Me vendimin nr. 341, datë 4.5.2021, KSHZ-ja ka miratuar tabelën përmbledhëse të rezulttit të votimit në zonën zgjedhore qarku Dibër, ku kandidati Elton Debreshi ka rezultuar me 580 vota të vlefshme.

9. Me vendimin nr. 407, datë 23.6.2021, KSHZ-ja, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, 162 dhe 163, të Kodit Zgjedhor, ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe ka përcaktuar kandidatët fitues në zonën zgjedhore qarku Dibër për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25.4.2021.

10. Me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, Komisioni Rregullator i KQZ-së ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, dhe konkretisht: a) numrin e votave për çdo subjekt zgjedhor në shkallë kombëtare; b) numrin e mandateve për çdo subjekt zgjedhor në shkallë kombëtare; c) listën emërore të deputetëve në shkallë kombëtare; ç) numrin e votave të çdo subjekti zgjedhor për çdo zonë zgjedhore; d) numrin e mandateve të çdo subjekti zgjedhor për çdo zonë zgjedhore; dhe dh) listën emërore të deputetëve për çdo zonë zgjedhore. Sipas lidhjes 1 të këtij vendimi (Numri i votave të çdo subjekti zgjedhor në shkallë kombëtare) dhe lidhjes 4 (Numri i votave të çdo subjekti zgjedhor për çdo zonë zgjedhore), kandidati Elton Debreshi ka marrë 580 vota ose 0.0368% në shkallë kombëtare dhe 0.90% në shkallë zone zgjedhore.

11. Kërkuesi nuk ka arritur të përmbushë kushtin e përcaktuar në nenin 162, pika 1, të Kodit Zgjedhor, si subjekt zgjedhor, pra marrjen e 1% të votave të vlefshme në shkallë kombëtare, për rrjedhojë nuk ka përfituar mandat.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. Kërkuesi ka pretenduar se përmbajtja e pikës 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor, ka cenuar të drejtën për t’u zgjedhur dhe parimin e barazisë së votave e mundësive të barabarta, të sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, si dhe parimin e barazisë para ligjit, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 14 të KEDNJ-së, duke parashtruar argumentet e mëposhtme:

12.1 Dispozita e kundërshtuar ka vendosur si prag zgjedhor kombëtar marrjen e 1% të votave të përgjithshme për të gjitha subjektet zgjedhore. Ky trajtim i njëlojtë është i gabuar dhe ka cenuar të drejtat e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, meqenëse ai kandidon vetëm në një zonë zgjedhore dhe merr vota vetëm aty, ndërkohë që partitë politike mbledhin vota nga të gjitha zonat zgjedhore të Republikës së Shqipërisë.

12.2 Vota për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit krahasuar me votën për kandidatin e propozuar nga partitë politike nuk ka vlerë të barabartë, për shkak të vendosjes së pragut të njëjtë elektoral për partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Rrjedhimisht, kjo ka ndikuar në ndryshimin e vullnetit të elektoratit të shprehur në kutinë e votimit, si dhe ka krijuar pabarazi në mënyrën e zgjedhjes së deputetëve.

13. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar, në mënyrë të përmbledhur, se:

13.1 Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, pasi dispozita e kundërshtuar e Kodit Zgjedhor nuk ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale për të. Numri i votave të marra nga kërkuesi është dukshëm më i ulët jo vetëm se numri i votave të kandidatëve të partive politike që kanë fituar mandat, por edhe se numri i zgjedhësve që e kanë mbështetur atë për regjistrimin si kandidat.

13.2 Në lidhje me themelin e kërkesës, përcaktimi ose ndryshimi i pragut zgjedhor ka rëndësi kushtetuese, pasi lidhet drejtpërdrejt me respektimin e parimit themelor të zgjedhjeve të barabarta dhe barazisë së votës, të sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës. Edhe barazisë së votës mund t’i vendosen kufizime, në përputhje me



standardet kushtetuese dhe parimin e proporcionalitetit. Diferencimet midis partive politike dhe sidomos vendosja e pragut zgjedhor justifikohen nga nevoja për shmangien e fragmentimit të tepërt dhe ruajtjen e funksionalitetit të parlamentit.

13.3 Caktimi i pragut elektoral është brenda hapësirës së vlerësimit dhe vendimmarrjes së Kuvendit dhe nuk bie ndesh me asnjë parim kushtetues. Neni 162 i Kodit Zgjedhor i vendos të gjitha subjektet zgjedhore në pozita të barabarta në shpërndarjen e mandateve.

13.4 Kërkuesi ka pasur dijeni, para regjistrimit si subjekt zgjedhor, për kuadrin ligjor zgjedhor dhe pragu 1% si kusht për të përfituar nga shpërndarja e mandateve. Mosarritja e këtij pragu ka ardhur prej mbështetjes së pamjaftueshme nga zgjedhësit në votim dhe jo prej përmbajtjes së dispozitës të kundërshtuar.

14. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, ka paraqitur mendimin këshillimor si vijon:

14.1 Caktimi i pragut zgjedhor lidhet ngushtë me sistemin zgjedhor dhe kur respektohen parimet e zgjedhjeve të lira, të ndershme e demokratike, ajo mbetet çështje e zgjedhjes politike të forcave qeverisëse të çdo shteti. Standardet e procesit zgjedhor, në një mënyrë ose tjetër, kushtëzohen nga pragu zgjedhor dhe, për këtë arsye, sistemi duhet të garantojë që pragu të mos bëhet pengesë për pjesëmarrjen reale në procesin zgjedhor.

14.2 Pragu kombëtar 1% duhet analizuar në kuadrin e së drejtës kushtetuese për të kuptuar nëse ofron të njëjtat mundësi pjesëmarrjeje dhe vlerësimi sipas kushteve të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor, si dhe nëse përveç barazisë formale ligji garanton edhe në praktikë barazinë përmbajtësore të pjesëmarrjes dhe të vlerësimit të të gjitha subjekteve zgjedhore në procesin zgjedhor.

14.3 Pragu zgjedhor që garanton pjesëmarrjen në procesin zgjedhor të të gjitha subjekteve zgjedhore në kushte barazie përmbajtësore është më pranë respektimit të standardeve më të mira ndërkombëtare, si dhe ligjshmërisë e legjitimitetit të zgjedhjeve.

15. Subjekti i interesuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka paraqitur mendimin këshillimor si vijon:

15.1 Parimi i konkurrimit të lirë të subjekteve zgjedhore, si koncept, përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta dhe

materializohet në legjislacionin që rregullon kushtet e konkurrimit. Çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i barazisë së subjekteve në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të sjellë diferencim apo trajtim preferencial dhe as të ndalojë ose pengojë pjesëmarrjen në konkurrimin zgjedhor.

15.2 Partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit janë subjekte zgjedhore të ndryshme. Partitë politike njihen dhe garantohen nga Kushtetuta (neni 9) dhe krijohen e ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas ligjit të posaçëm nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar. Si grupime me strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, ato mund të shtrihen e veprojnë në të gjithë territorin e vendit dhe të kandidojnë në të gjitha zonat zgjedhore, ndërkohë që kandidati i propozuar nga zgjedhësit, i parashikuar në Kodin Zgjedhor (nenet 69 dhe 70), është subjekt i përkohshëm, që përfshihet vetëm në procesin zgjedhor. Si i tillë, ai nuk propozohet e as nuk mbështetet dot nga çdo zgjedhës, po vetëm nga zgjedhësit e zonës përkatëse dhe nuk lejohet të kandidojë në çdo zonë zgjedhore.

15.3 Pavarësisht se në kuptimin formal të gjitha subjektet zgjedhore trajtohen si të barabarta në ligji, duke u vendosur të njëjtin nivel pragu kombëtar 1% si kusht për gëzimin e së drejtës për shpërndarje mandatesh, kandidati i propozuar nga zgjedhësit nuk ka mundësi reale e faktike të konkurrojë në shkallë kombëtare për ta kaluar pragu. Në këto kushte, krijohet dyshimi i arsyeshem se *prima facie* ky rregullim ligjor e vendos në kushte më pak të favorshme kandidatin e propozuar nga zgjedhësit krahasuar me subjektet e tjera zgjedhore.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

16. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, për kundërshtimin e përmbajtjes së pikës 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor.

17. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues, pasi dispozita e kundërshtuar nuk i ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta dhe reale. Sipas këtij subjekti, nga



vendimi i KSHZ-së nr. 341, datë 4.5.2021 rezulton se kërkuesi ka marrë gjithsej 580 vota, pra dukshëm nën numrin e votave të kandidatëve të partive politike të cilët kanë marrë mandat, madje edhe nën numrin e zgjedhësve që e kanë mbështetur atë për t'u regjistruar si kandidat.

18. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

19. Kjo dispozitë kushtetuese është zbërthyer konkretisht në ligjin nr. 8577/2000, që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (neni 71), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (neni 71/a). Sipas pikës 2 të nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, objekti i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, nëse përmbushen kriteret e parashikuara nga neni 49, pika 3, shkronja "e", i tij, të cilat lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave dhe lirive kushtetuese, shterimin e të gjitha mjeteve juridike përkatëse dhe zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të aktit objekti ankimi, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore.

20. Bazuar në përmbajtjen e normës kushtetuese dhe të normave ligjore, Gjykata vëren se kur objekti i ankimit kushtetues individual është një ligj ose një akt normativ, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriterë: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*).

21. Në kuptim të kriterëve të mësipërme, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur, në vështrim edhe të parimit të barazisë në ligj, të sanksionuara në nenet 45 dhe 18 të Kushtetutës. Kërkuesi, i regjistruar me vendimin nr. 118, datë 8.3.2021 të KSHZ-së si kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25.4.2021 në zonën zgjedhore qarku Dibër, është subjekt i së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur, prandaj legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "P" dhe 134, pika 1, shkronja "I" e pika 2, të Kushtetutës, si edhe neneve 71 dhe 49, pika 3, shkronja "e", të ligjit nr. 8577/2000.

22. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individit duhet, së pari, t'i kundërshtojë ato para gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislati nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Megjithatë mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij.

23. Gjykata vlerëson se në rastin konkret dispozita ligjore e kundërshtuar nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e saj, por është drejtpërdrejt e zbatueshme ndaj kërkuesit që prej momentit kur ai është regjistruar me vendim të KSHZ-së për të marrë pjesë në zgjedhje si kandidat i propozuar nga zgjedhësit. Në këto kushte, kërkuesi nuk ka mjete të tjera në dispozicion për të shteruar përveç paraqitjes së kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën, pra paraqitjes së ankimit kushtetues individual për rivendosjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar.



24. Lidhur me afatin ligjor të paraqitjes së kërkesës, bazuar në nenin 50, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, ajo duhet të paraqitet brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit. Gjykata vlerëson se në rastin e ankimit kushtetues individual konstatimi i cenimit si rregull nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ. Në këto raste afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për kërkuesin ose, thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ. Në këtë kuptim, nxjerrja e vendimit të KQZ-së është momenti që sjell cenimin e së drejtës dhe, për rrjedhojë, kërkuesit i ka lindur e drejta të paraqesë ankimin kushtetues individual nga data e nxjerrjes së tij. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, pra përmbush edhe kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*.

25. Për sa i përket kriterit të legjitimitetit *ratione materiae*, sipas të cilit cenimi i të drejtave themelore duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe real, kërkuesi duhet të provojë se është viktimë e një shkeljeje dhe se preket drejtpërdrejt nga kufizimi i vendosur prej aktit të kundërshtuar. Gjykata vlerëson se edhe pse në çastin e paraqitjes së kërkesës nuk kishte dalë një akt individual ndaj kërkuesit që të provonte ardhjen e pasojave nga zbatimi i dispozitës së kundërshtuar, fakti i regjistrimit të tij si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për të marrë pjesë në zgjedhje është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues. Kjo do të thotë se zbatimi i pikës 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor, do të ndodhte me siguri, në formën e aktit përmbyllës të procesit ku kërkuesi ishte regjistruar si subjekt zgjedhor. Duke pasur parasysh thelbin e pretendimeve për cenimin e së drejtës për t'u zgjedhur, në vështrim edhe të parimit të barazisë në ligj, kërkuesit nuk mund t'i kërkohej të paraqiste ankim kushtetues vetëm pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të pafavorshëm për të, pasi ankimi kushtetues do ta humbiste qëllimin e tij, që është rivendosja e së drejtës kushtetuese të shkelur.

26. Gjykata konstaton se kërkuesi kundërshton pikën 1 të nenit 162 në tërësinë e saj, por nuk ka ngritur pretendime dhe nuk ka arritur të provojë cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave kushtetuese nga përmbajtja e fjalisë së parë të kësaj dispozite, pra nuk justifikon interesin e tij për kundërshtimin e asaj pjese të dispozitës ligjore.

27. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, por vetëm për kundërshtimin e fjalisë së dytë të pikës 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor, prandaj pretendimet për papajtueshmërinë me Kushtetutën të kësaj fjalie, që parashikon, se: “*për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi*”, do të shqyrtohen në vijim prej saj.

B. Për themelin e pretendimeve

28. Sipas kërkuesit, kandidati i propozuar nga zgjedhësit nuk gëzon të njëjtin trajtim si subjektet e tjera zgjedhore, pasi ai kandidon dhe mund të marrë vota vetëm në një zonë zgjedhore të caktuar, ndërsa partitë politike mbledhin vota në të gjitha zonat zgjedhore të vendit. Nisur nga natyra e subjekteve zgjedhore, duket e pakuptimtë që atyre t'u vendoset i njëjti prag zgjedhor. Sipas tij, vota për kandidatin e propozuar nga zgjedhësit nuk ka vlerë të barabartë me atë për kandidatin e propozuar nga partitë politike. Vendosja e një pragu të njëjtë elektoral për të gjitha subjektet zgjedhore ka ndryshuar kuptimin dhe peshën e votës, gjë që mund të ndikojë në ndryshimin e vullnetit të elektoratit të shprehur në kutitë e votimit. Ligji e diskriminon kandidatin e propozuar nga zgjedhësit, pasi ai mund të fitojë mandat vetëm nëse merr 1% të votave në shkallë kombëtare, ndërkohë që kandidati i një partie politike fiton mandat edhe po të marrë një numër më të vogël votash.

29. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit, pika 1, e nenit 162, të Kodit Zgjedhor, nuk bie në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe subjektet zgjedhore trajtohen nga pozita të barabarta në procesin e shpërndarjes së mandateve. Sipas këtij subjekti, para se të regjistrohej në KQZ si subjekt zgjedhor, kërkuesi ka pasur dijeni për kuadrin ligjor dhe prapun 1% si kusht për t'u përfshirë në shpërndarjen e mandateve. Mosarritja e pragut elektoral prej tij nuk vjen nga përmbajtja e nenit 162, të Kodit Zgjedhor, por nga mungesa e mbështetjes së zgjedhësve gjatë procesit të votimit. Ndërsa përcaktimi i nivelit të pragut elektoral është e drejtë e Kuvendit dhe mund të justifikohet nga qëllimi, që është shmangia e fragmentimit të tepërt dhe ruajtja e funksionalitetit të Parlamentit.

30. Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit, është shprehur se vendosja e pragut zgjedhor lidhet ngushtë me sistemin zgjedhor dhe nëse



respektohen parimet e zgjedhjeve të lira, të ndershme e demokratike, ajo mbetet çështje e zgjedhjes politike të forcave qeverisëse të çdo shteti. Standardet e procesit zgjedhor, në një mënyrë ose tjetër, kushtëzohen nga pragu zgjedhor, por sistemi duhet të garantojë që ai të mos shndërrohet në pengesë për pjesëmarrjen reale në procesin zgjedhor. Pragu kombëtar 1% që ka përcaktuar Kodi Zgjedhor duhet analizuar nga këndvështrimi kushtetues për të kuptuar nëse ofron të njëjtat mundësi pjesëmarrjeje dhe vlerësimi të rezultateve, si dhe nëse barazia formale e parashikuar nga ligji garanton *a priori* edhe në praktikë barazi në pjesëmarrjen reale dhe në vlerësimin e rezultateve të të gjitha subjekteve zgjedhore në procesin zgjedhor.

31. Sipas subjektit të interesuar, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parimi i konkurrencës të lirë të subjekteve zgjedhore përfshin detyrimin e shtetit për të respektuar shanset e barabarta për të gjithë dhe materializohet në legjislacionin që rregullon kushtet e këtij konkurrencës. Bazuar në nenin 162, të Kodit Zgjedhor, ndonëse subjektet zgjedhore trajtohen parimisht njëjloj në të drejtën për shpërndarje mandatesh, në praktikë kandidati i propozuar nga zgjedhësit ndodhet në një situatë jo të favorshme krahasuar me partitë politike. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit ka detyrimin të arrijë prapun kombëtar prej 1%, ndërkohë që nuk ka mundësi reale të konkurrojë në shkallë kombëtare për ta arritur atë, si kusht që lidhet me shpërndarjen ose jo të mandateve.

32. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuarit lidhen me cenimin e së drejtës për t'u zgjedhur si përfaqësues i sovranitetit të popullit në Kuvend, siç parashikohet në nenin 45 të Kushtetutës, i parë së bashku me nenin 18 të saj, i cili sanksionon parimin e barazisë në ligj. Për të arritur në një përfundim sa më të drejtë për pajtueshmërinë e pikës 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor, me nenet 45 dhe 18, të Kushtetutës, Gjykata vlerëson të ndalet fillimisht në analizën e sistemit zgjedhor dhe të elementeve kryesore të tij e, më pas, në parimet kushtetuese dhe ndërkombëtare që zbatohen gjatë procesit zgjedhor për garantimin edhe të së drejtës për t'u zgjedhur dhe shanseve të barabarta, e parë së bashku me parimin kushtetues të barazisë në ligj.

B.1. Standardet e sistemit zgjedhor

33. Neni 2 i Kushtetutës sanksionon sovranitetin e popullit si parim të rëndësishëm kushtetues dhe në pikën 2 përcakton mënyrën e ushtrimit të këtij sovraniteti, pra nëpërmjet përfaqësuesve ose drejtpërsëdrejti.

34. Gjykata ka theksuar se demokracia përfaqësuese është konceptuar si formë e zakonshme qeverisjeje. Ajo është shprehje e demokracisë që mundëson shfaqjen e vullnetit të shumicës në formën e një akti që do t'i shërbejë interesit të përgjithshëm (*shih vendimin nr. 31, datë 19.11.2003, të Gjykatës Kushtetuese*). Zgjedhjet parlamentare janë përbërës thelbësorë të formës demokratike të qeverisjes. Vetëm përmes tyre mund të bëhet realitet parimi i rëndësishëm i sovranitetit të popullit, si dhe konstituimi demokratik i pushtetit shtetëror. Kushtetuta pohon në nenin 1, pika 3, se qeverisja bazohet në një sistem zgjedhjesh të lira, të barabarta, të përgjithshme dhe periodike. Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe ndërtimi i një shteti të përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve (*shih vendimet nr. 32, datë 21.6.2010; nr. 9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Konkurrimi i lirë është shprehje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të një shoqërie demokratike dhe bazohet edhe në faktin që për të gjitha subjektet të zbatohen të njëjtat rregulla të përcaktuara më parë. Këto rregulla bazohen në parimin e mosdiskriminimit, të mostrajimit preferencial, por të dhënies së mundësive të njëjta në konkurrencën politik. Çdo kufizim në barazinë e palëve në konkurrencën elektorale nuk mund të arrijë deri aty sa të bëjë të pamundur edhe vetë pjesëmarrjen e tyre në konkurrencë (*shih vendimet nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 28, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në vlerësimin e Gjykatës, në përcaktimin e një sistemi zgjedhor duhet të merren në konsideratë shumë faktorë, siç janë ata historikë, politikë, etnikë, kulturorë, shoqërorë apo gjeografikë. Çdo sistem zgjedhor në një shoqëri demokratike synon të sigurojë stabilitet dhe qeverisje efektive e të qëndrueshme dhe, njëkohësisht, një përfaqësim sa më të gjerë të popullit dhe shprehje sa më të plotë të vullnetit të



tij. Në parim, çdo sistem zgjedhor konsiderohet, në tërësinë e tij, demokratik në qoftë se nëpërmjet tij respektohen të gjitha rregullat e konkurrimit të drejtë e të barabartë. Në radhë të parë, sistemi zgjedhor dhe procedurat që lidhen me zbatimin e tij duhet të garantojnë e të vënë në zbatim përfaqësimin real të komunitetit dhe ushtrimin adekuat të sovranitetit të popullit (*shih vendimin nr. 1, datë 30.1.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Problemet e përfaqësimit të drejtë lidhen me shanset e barabarta, pra që zëri i gjithkujt të dëgjohet ose të jetë i përfaqësuar. Sidoqoftë, është e pranueshme që një shtet demokratik, për arsye serioze, të vendosë në mekanizmat e procesit zgjedhor disa elemente nxitëse të integritetit shoqëror. Një sistem zgjedhor proporcional i pakufizuar mund të rezultojë në ndarjen e votave të qytetarëve ndërmjet një numri shumë të madh partish politike dhe, për pasojë, në një kërcënim për funksionimin dhe vazhdimësinë e sistemit parlamentar, në kuptim të kapaciteteve për të arritur në një vendimmarrje brenda tij (*shih vendimin nr. 32, datë 21.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Kushtetuta parashikon sistemin zgjedhor proporcional me tipare të tilla, si: konkurrimi rajonal, pragu kombëtar, listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, votat parapëlqyese dhe përfaqësimi gjinor. Në pikën 2 të nenit 64 të Kushtetutës parashikohet se në shpërndarjen e mandateve marrin pjesë subjektet zgjedhore që arrijnë pragu kombëtar, kurse në pikën 3 parashikohet se përcaktimi i kriterëve dhe rregullave të zbatimit të sistemit zgjedhor, zonave zgjedhore, pragut kombëtar, numrit të mandateve për secilën zonë, shpërndarjes së mandateve dhe masës së shtrirjes së votimit parapëlqyës i delegohet për trajtim ligjit zgjedhor. Neni 68 i Kushtetutës parashikon se kandidatët për deputetë paraqiten në nivel zone zgjedhore nga partitë politike ose nga zgjedhësit, kurse rregullat dhe kriteret për regjistrimin e kandidatëve për deputetë, për organizimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë ato për regjistrimin e zgjedhësve, zhvillimin e fushatës zgjedhore, administrimin, vlefshmërinë e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultateve të tyre, përcaktohen në ligjin për zgjedhjet.

39. Vendosja e pragut zgjedhor ndikon në ndarjen e vendeve në parlament, sipas rezultateve të zgjedhjeve, dhe është pranuar edhe nga

GJEDNJ-ja, e cila ka vlerësuar, se, sipas nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk është e thënë që të gjitha votat të kenë peshë të barabartë në drejtim të rezultatit të zgjedhjeve dhe as që të gjithë kandidatët të kenë shanse të barabarta për të fituar. Pra asnjë sistem zgjedhor nuk mund të shmangë që disa vota të shkojnë dëm” (*shih partia “Jaunie Demokrati” dhe partia “Mësu Zeme” kundër Letonisë, datë 29.11.2007*). GjEDNJ-ja ka theksuar se pragu mund të veprojë si rregullator i nevojshëm që bën korrigjime në sistemin proporcional, kurdoherë i pranuar si sistem që mundëson shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve, ndonëse mund të jetë në dëm të partive të vogla, kur shoqërohet nga një prag të lartë (*shih Yumak dhe Sadak kundër Turqisë, Dhoma e Madhe, datë 8.7.2008, § 122*). Ndërsa për sa i përket nivelit të pragut, GjEDNJ-ja ka vlerësuar se pragu 5% si kusht për të marrë pjesë në ndarjen e vendeve në parlament, është në përputhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1, pasi nxit në një shkallë të mjaftueshme rrymat e mendimit dhe ndihmon në shmangien e një copëzimi të tejskajshëm të tij (*shih partia “Jaunie Demokrati” dhe partia “Mësu Zeme” kundër Letonisë, datë 29.11.2007*).

40. Gjykata vlerëson se sistemet zgjedhore synojnë të arrijnë objektiva që jo gjithmonë përputhen: nga njëra anë të pasqyrojnë besnikërisht mendimet e njerëzve dhe, nga ana tjetër, të kanalizojnë rrymat e mendimit për të ushqyer vullnetet politike krejt të qarta dhe koherente. Pragu zgjedhor në sistemin proporcional, si një mekanizëm përjashtues ose përfshirës, ndikon sidomos te partitë e vogla ose të pakicave dhe synon krijimin e shumicave të qëndrueshme në parlament dhe mënjanimin e copëzimit të sistemit partiak. Sistemet proporcionale karakterizohen nga rezultate më proporcionale dhe pragje efektive më të ulëta. Duke pasur parasysh se shanset e votimit varen nga niveli i proporcionalitetit të sistemit, është e pritshme që kandidatët e mbështetur nga zgjedhësit (pra të pavarur nga partitë politike) të dalin me rezultate më të mira në sisteme pa prag ligjor ose me nivele më të larta proporcionaliteti.

41. Nisur nga sa më lart, Gjykata thekson se pragu zgjedhor kombëtar është tipar kushtetues dhe ka natyrën e një kushti që, kur arrihet nga subjektet zgjedhore të parashikuara në nenin 68 të Kushtetutës, u jep të drejtën të përfshihen në shpërndarjen e mandateve. Ai është parashikuar nga neni 64 i Kushtetutës, kurse caktimi i nivelit të



tij i është lënë për vlerësim ligjvënësit në ligjin për zgjedhjet. Ndonëse pragu kombëtar vepron si mekanizëm korigjues në sistemin proporcional, ai, në vlerësimin e Gjykatës, nuk duhet të privojë zgjedhësit nga përfaqësimi ose nga ushtrimi i së drejtës së votës, me anë të së cilës ata mund të ndikojnë, aq sa mundet, në mënyrë të njëjlojtë dhe me të njëjtën peshë në rezultatin e zgjedhjeve.

B.2. Standardet e së drejtës së votës. Parimi i mosdiskriminimit

42. Sipas nenit 45, pika 1, të Kushtetutës, çdo shtetas që ka mbushur tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Kurse sipas pikës 4 të tij, vota është vetjake, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.

43. Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj rëndësinë e së drejtës së votës, si një nga të drejtat themelore politike që gëzon individ. Kontributi kryesor i saj është garantimi i mundësisë për të gjithë zgjedhësit, pa dallime mbi bazë shtrese ose përkatësie në grupe të caktuara shoqërore, ose mbi baza të tjera që të ndikojnë në formimin e vullnetit politik në një shoqëri demokratike (*shih vendimet nr. 28, datë 13.7.2021; nr. 40, datë 16.11.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se e drejta e votës ushtrohet përmes një sistemi zgjedhor që garanton fshehtësinë, lirinë dhe barazinë e saj, duke u siguruar shtetasve qenien e tyre politikisht aktivë e duke formuar në këtë mënyrë thelbin e rolit që duhet të kenë ata në një sistem demokratik (*shih vendimet nr. 40, datë 16.11.2007; nr. 1, datë 7.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i barazisë së votës, që përfshin komponentin e tij aktiv (e drejta për të votuar) dhe atë pasiv (e drejta për t'u votuar/zgjedhur), ndalon diskriminimin ose privilegjimin nga shteti të kandidatëve të caktuar, parti politike ose grupe të tjera politike në garën për të tërhequr votën e zgjedhësit. Barazia në zgjedhje përfshin shumë aspekte dhe parimet që duhen respektuar në të gjitha rastet janë barazia në votën numerike, në fuqinë zgjedhore dhe në mundësi, dhe kjo e fundit kërkon që midis partive dhe kandidatëve të krijohen shanse të barabarta dhe shteti të jetë i paanshëm ndaj tyre, duke zbatuar ligjet në mënyrë të njëjtë për të gjithë (*shih vendimet nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 28, datë 9.5.2012; nr. 32, datë 21.6.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas këtij parimi, çdo votë ka të njëjtën vlerë dhe të njëjtën mundësi ligjore suksesi dhe çdo votues duhet të ndikojë në

mënyrë të barabartë në rezultatet e zgjedhjeve. Sistemi proporcional synon që të gjitha palët të përfaqësohen në përqindje që është sa më pranë numrit të votave dhe formalizimi i barazisë së votës shkon më tej, që do të thotë jo vetëm vlerë numerike e njëjtë, por edhe vlerë e njëjtë suksesi ose ndikim i njëjtë në rezultat (*shih vendimin nr. 1, datë 7.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se ligjvënësi, gjatë hartimit të ligjeve, duhet të vlerësojë edhe faktorë të tjerë që mund të diktohen nga kushte të ndryshme specifike, me qëllim krijimin e një mekanizmi të përshtatshëm zgjedhor që të sigurojë një përfaqësim të drejtë dhe efektiv. Duke u nisur nga parimet demokratike mbi të cilat janë ndërtuar kushtetutat moderne, është e kuptueshme edhe tendenca e ligjvënësit për t'i kushtuar rëndësinë e duhur trajtimit të barabartë të shtetasve në procesin e shprehjes së vullnetit politik (*shih vendimin nr. 1, datë 7.1.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata çmon se përmbajtja e nenit 45 të Kushtetutës duhet të shihet e lidhur edhe me nenin 18 të Kushtetutës, i cili sanksionon shprehimisht parimin e barazisë përpara ligjit, si dhe ndalon diskriminimin e padrejtë, ndër të tjera, edhe për shkak të bindjeve politike.

47. Neni 18 i Kushtetutës është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, ku është theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 48, datë 15.11.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Gjykata rithekson se organi ligjvënës është i detyruar t'i përmbahet këtij parimi kur bëhet fjalë për “barazinë në ligj”. Për të vlerësuar nëse një ligj është diskriminues në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, Gjykata shqyrton nëse ligji ka



përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe, në rast se e konstaton këtë fakt, vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 48, datë 15.11.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, prandaj Gjykata, në rast trajtimi të njëjtë të subjekteve, shqyrton nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive, pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme (*shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Përkufizimi i një rregullimi juridik, pavarësisht nëse është arsyetuar objektivisht ose jo, nuk është vetëm çështje thjesht juridike, por kërkon edhe një vlerësim real (*shih vendimin nr. 27, datë 29.6.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Parimisht është e drejta e ligjvënësit të zgjedhë se cilat rrethana do të kenë pasojat juridike të njëjta, me qëllim që t'i rregullojë ato juridikisht në mënyrë të njëlojtë. Por këtë zgjedhje ligjvënësi duhet ta argumentojë në mënyrë të arsyeshme. Fakti nëse në raste të caktuara është respektuar ose jo në thelb parimi i barazisë, nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por duhet të shihet në lidhje me veçoritë dhe karakteristikat e çështjes konkrete që synohet të rregullohet (*shih vendimin nr. 60, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Mbrojtja kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara nga KEDNJ-ja garantohej edhe nga neni 14 i saj, si parim thelbësor i shtetit të së drejtës dhe me rëndësi themelore për vlerat e tolerancës dhe paqes shoqërore. Kjo mbrojtje përfordhet edhe nga neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon në çdo rast diskriminimin edhe në gëzimin e të drejtave të parashikuara nga ligji. Neni 14 i KEDNJ-së gjen zbatim edhe kur shtetet, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, nuk trajtojnë ndryshe persona që ndodhen në situata dukshëm të ndryshme (*shih Envida dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 15.1.2013, § 87*). Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk

jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose ‘status’ të dallueshëm” (*shih Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.5.2016, § 89*). Diskriminimi i tërthortë mund të marrë formën e paragjyqimeve joproporcionale të një politike ose mase me karakter të përgjithshëm, e cila, edhe pse shfaqet në terma neutralë, ka efekt të posaçëm diskriminues mbi një grup të veçantë (*shih Sampanis dhe të tjerë kundër Greqisë, datë 5.6.2008, § 67; D.H. dhe të tjerë kundër Republikës Çeke, Dhoma e Madhe, datë 13.11.2007, § 184*). Edhe nëse politika ose masa në fjalë mund të mos ketë qëllim ose të mos jetë specifikisht e drejtuar ndaj një grupi të caktuar, ajo mundet megjithatë ta diskriminojë këtë grup në mënyrë të tërthortë (*shih Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 4.5.2001, § 154*). Diskriminimi i tërthortë nuk është e thënë të ketë patjetër qëllim diskriminues. Ky lloj diskriminimi mund të lindë nga një rregull neutral (*shih Hoogendijk kundër Holandës, datë 6.1.2005*) ose nga një situatë faktike (*shih Zarb Adami kundër Maltës, datë 20.6.2006, § 76*).

51. Dispozita e nenit 162 të Kodit Zgjedhor, objekt shqyrtimi, parashikon: “Për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi”. Ajo solli si risi vendosjen e një pragu kombëtar dhe përcaktoi rregullat e shpërndarjes së mandateve në varësi të arritjes së këtij pragu. Në këtë kontekst të ri, Gjykata vëren se partitë politike dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, si subjekte zgjedhore të njohura nga neni 68 i Kushtetutës, u garantohej barazia formale për sa i përket shpërndarjes ose jo të mandateve. Nga sa më sipër, duke theksuar se diskriminimi shfaqet në dy forma: drejtpërdrejt ose tërthorazi, Gjykata çmon të vlerësojë nëse dispozita e kundërshtuar garanton edhe barazinë përmbajtësore mes këtyre subjekteve, duke analizuar faktin nëse ato ndodhen në kushte të njëjta ose të ndryshme dhe nëse kanë karakteristika të tilla ose status që diktojnë nevojën për t'u trajtuar ndryshe.

52. Gjykata vëren se partitë politike janë tipar dallues i demokracive moderne, element kyç i konkurrencës elektorale dhe instrument i rëndësishëm për krijimin e urave lidhëse mes individit dhe shtetit. Ato funksionojnë si struktura



mbi baza të qëndrueshme dhe kontribuojnë në shfaqjen dhe përfaqësimin e vullnetit politik të popullit përmes pjesëmarrjes në zgjedhje dhe ndihmojnë në realizimin e sovranitetit të tij. Roli i tyre konsiston në integrimin e grupeve dhe të individëve në procesin politik, në formulimin e përfaqësimit të interesave të tyre, si dhe në ushtrimin e kontrollit mbi ekzekutivin. Për shkak të këtyre funksioneve ato konsiderohen pjesëtare të domosdoshme dhe faktorë në zhvillimin e jetës politike e shoqërore të vendit. Në kuptimin kushtetues ato paraqiten si bashkime vullnetare mbi bazën e ideve, të bindjeve e pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit (*shih vendimet nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 11, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 13.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Nga ana tjetër, edhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit janë parashikuar si kategori kushtetuese në nenin 68 të Kushtetutës, i cili e ka njohur si subjekt që ka të drejtë të marrë pjesë në procesin zgjedhor krahas kandidatëve që mbështeten nga partitë politike. Pavarësisht se dallohet nga partitë politike, për shkak të mënyrës së organizimit dhe funksionimit, edhe ky subjekt zgjedhor ndikon në cilësinë e përfaqësimit nëpërmjet rolit të tij në çështje themelore për demokracinë, siç janë pjesëmarrja e votuesve në zgjedhje, llogaridhënia e qeverisë dhe përgjegjshmëria e saj. Por ky ndikim varet thellësisht nga forca e pesha e tij zgjedhore, e cila varet nga sistemet elektorale që mund të ndikojnë duke vendosur kritere për konkurrin (kërkesa për t'u regjistruar si kandidat, madhësia e qarkut dhe pragu elektorale). Prandaj është me rëndësi që ligjvënësi të mos vendosë barriera të tilla që do të sillnin zbehjen e dëshirës për pjesëmarrje në garën zgjedhore të kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, përkundrazi të synojë nxitjen e pjesëmarrjes së kësaj kategorie në procesin zgjedhor, duke i dhënë mundësi të masë forcat në sytë e zgjedhësve dhe të votuesve.

54. Gjykata vëren se neni 63 i Kodit Zgjedhor përkufizon si subjekt zgjedhor një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në Kodin Zgjedhor. Sipas pikës 2 të këtij neni, subjekt zgjedhor mund të jetë edhe shtetasi shqiptar me të

drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet nga një grup zgjedhësish, sipas rregullave përkatëse të ligjit zgjedhor. Ndërsa në pikën 3 të po këtij neni parashikohet se kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ. Sipas nenit 68, listat e kandidatëve për Kuvendin, të paraqitura nga partitë politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të mbështeten nga jo më pak se 5,000 zgjedhës në shkallë kombëtare. Në rastin e koalicionit zgjedhor listat në tërësi duhet të kenë marrë mbështetjen e jo më pak se 7,000 zgjedhësve në shkallë kombëtare. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni, ku partitë pjesëtare zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

55. Procedura e regjistrimit të kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet në Kuvend rregullohet në nenin 69 të Kodit Zgjedhor. Sipas tij, një grup zgjedhësish në një zonë zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për atë zonë zgjedhore, që përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 45 të Kushtetutës dhe në nenin 63 të këtij kodi, dhe që nuk është pjesë në asnjë parti apo koalicion që konkurren në zgjedhje dhe nuk mbështet haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në zgjedhje. Paraqitja e kandidatit nga zgjedhësit bëhet nga një komitet nismëtar i krijuar enkas e që organizon punën për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse (jo më pak se 1% e listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por jo më shumë se 3,000 zgjedhës), duke u përjashtuar nga ky rregull kandidati që është deputet.

56. Duke pasur parasysh përmbajtjen e dispozitave të Kodit Zgjedhor, Gjykata vëren, se kandidati i propozuar nga zgjedhësit, edhe pse përfshihet në përkufizimin *subjekt zgjedhor*, dallohet dukshëm nga subjektet e tjera zgjedhore (partitë politike dhe koalicionet zgjedhore) si në drejtim të mënyrës së krijimit dhe regjistrimit, ashtu edhe të hapësirës territoriale ku zhvillon fushatën zgjedhore dhe kërkon mbështetjen e zgjedhësve. Ndërkohë që partitë ose koalicionet zgjedhore marrin vota në të gjithë vendin, të cilat më pas përkthehen në mandate përfaqësuese që ndahen mes kandidatëve të listës për çdo zonë zgjedhore, kandidati i propozuar nga zgjedhësit merr vota vetëm në



zonën zgjedhore ku kandidon, duke synuar arritjen e pragut kombëtar 1%, njëlloj si subjektet e tjera zgjedhore. Kodi Zgjedhor parashikon se partitë politike, në dallim nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, kanë të drejtë të marrin pjesë në koalicione zgjedhore, për të realizuar disa synime, ndër të cilat, më kryesori lidhet me maksimalizimin e numrit të votave, që më pas përkthehen në mandate sipas rregullave përkatëse të Kodit Zgjedhor. Për partitë politike të vogla, pjesëmarrja në koalicion ndikon pozitivisht në arritjen e pragut kombëtar, pra 1% të votave të vlefshme, dhe renditjen e disa kandidatëve të tyre në vendet fituese të listës, sipas marrëveshjes. Këto përfitime lidhen më pas drejtpërdrejt me përfitimin e financimit nga buxheti i shtetit, i cili vendos kushtin e arritjes së pragut kombëtar, duke ndjekur më pas rregullat e numrit të mandateve të fituara në raport me numrin e votave të vlefshme (*shih vendimin nr. 27, datë 29.6.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

57. Bazuar në përmbajtjen e dispozitave të Kodit Zgjedhor, si kandidatët që mbështeten nga partitë politike (pra janë të përfshirë në listat e tyre), ashtu dhe ata që mbështeten dhe propozohen nga zgjedhësit, mund të kandidojnë vetëm në një zonë zgjedhore. Por në ndryshim nga kandidati i propozuar nga zgjedhësit, kandidati i partisë politike ose koalicionit zgjedhor, i cili në fakt nuk përmendet si subjekt zgjedhor, me arritjen e pragut kombëtar dhe ndarjen e numrit të mandateve mes partive politike, merr pjesë në ndarjen e mandateve për kandidatët e listës shumemërore në bazë të votave të marra në zonën zgjedhore përkatëse, sipas formulës së parashikuar nga ligji zgjedhor. Kjo do të thotë që edhe pse kandidojnë në të njëjtën zonë zgjedhore, mënyra e llogaritjes së vlerës së votës për këto dy kategori kandidatësh është e ndryshme. Po ashtu, lidhur me regjistrimin e tij si subjekt zgjedhor, kandidatit të propozuar nga zgjedhësit i kërkohet mbështetje nga një numër i caktuar zgjedhësish në zonën zgjedhore ku ai kandidon, ndërkohë që për të marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve atij i kërkohet të plotësojë kushtin e pragut zgjedhor në nivel kombëtar, në të njëjtën mënyrë dhe masë si subjektet e tjera zgjedhore.

58. Gjykata vlerëson se “kandidati i propozuar nga zgjedhësit” nuk ndodhet në situatë të njëjtë me subjektet zgjedhore “parti politike” dhe “koalicion partish politike”. Për rrjedhojë, parashikimi i

rregullave të njëjta lidhur me kufizimin e shpërndarjes së mandateve bazuar mbi të njëjtin prag, të përcaktuar në shkallë kombëtare, përbën diskriminim të tërthortë të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit në të drejtën për t’u zgjedhur dhe për shanse të barabarta në procesin zgjedhor. Siç u theksua edhe më sipër, Gjykata vlerëson se ky diskriminim vjen nga një normë që edhe pse në dukje respekton parimin e barazisë mes subjekteve zgjedhore, faktikisht sjell pabarazi të dukshme në gëzimin e të drejtave të garantuara nga Kushtetuta. Nisur nga natyra, mënyra e krijimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së këtyre subjekteve zgjedhore, ato nuk mund të trajtohen në mënyrë të barabartë në drejtim të pragut elektoral të detyrueshëm, pasi vlera e votave të vlefshme nuk përkthehet në mënyrë të njëjtë në vlerën e votës efektive. Me caktimin e pragut të njëjtë elektoral si për partitë politike ose koalicionet, ashtu dhe për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, ka ndryshuar kuptimi dhe pesha e votës dhe, për këtë arsye, mund të ndryshojë vullneti i elektoratit në kutinë e votimit. Kandidati i propozuar nga zgjedhësit, si kusht për të përfituar nga shpërndarja e mandateve, duhet të arrijë pragun kombëtar 1%, por faktikisht nuk ka mundësi reale të konkurrojë në shkallë kombëtare për ta arritur atë. Pra duket qartazi se praktikisht është shumë e vështirë, madje thuajse e pamundur, që një kandidat i pavarur të fitojë mandat për të përfaqësuar mbështetësit e zonës së tij zgjedhore.

59. Sipas vendimit nr. 21, datë 13.7.2021 të Komisionit Rregullator të KQZ-së, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021”, numri i votave të vlefshme në rang vendi është 1,578,117 (100%), kurse numri i votave të vlefshme në zonën zgjedhore qarkun Dibër është 64,297. Bazuar në pikën 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor, numri i votave të vlefshme që duhet të merrte kërkuesi për të marrë pjesë në shpërndarjen e mandateve është jo më pak se 15,781.17, që nëse do të përkthehej në përqindje në rang qarku, është afërsisht 25% e numrit të përgjithshëm të votave. Nga ana tjetër, duke iu referuar akteve të organeve të KQZ-së për miratimin e tabelave përmbledhëse për rezultatit të votimit në zonat zgjedhore dhe shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, Gjykata konstaton se ka kandidatë në listat shumemërore të partive politike të këtyre zgjedhjeve në qarkun Tiranë që kanë



marrë mandat me më shumë pak vota sesa numri i votave të nevojshme për kandidatin e pavarur në zonën zgjedhore përkatëse. E njëjta mospërputhje është shfaqur edhe në rastin e kandidatëve me votë parapëlqyese, për të cilët Kodi Zgjedhor përcakton një lloj tjetër pragu për përfitimin e mandatit jashtë listës shumemërore të partive politike ose koalicioneve të partive politike (herësi), i cili sërish është më i ulët se sa niveli i pragut kombëtar që duhet të arrijë kandidati i propozuar nga zgjedhësit për të përfituar mandat në parlament.

60. Në analizë të sa më lart, Gjykata vlerëson se pragu prej 1% për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit nuk është i përligjur, pasi nuk rezulton të jetë prag natyral, pra i përafërt me numrin e votave që i takojnë një mandati deputeti. Në këtë kuptim, edhe prapësimi i përfaqësueses së subjektit të interesuar, Kuvendit, se niveli 1% i numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme në shkallë kombëtare është vendosur për ta sjellë sa më pranë pragut natyral, pra numrit të votave të nevojshme për marrjen e një mandati deputeti, rezulton i pabazuar.

61. Gjykata vlerëson se zgjedhjet kanë si objektiva ruajtjen e natyrës së tyre si një faktor integruar në procesin e formimit të politikave nga populli dhe krijimin e kushteve që organi përfaqësues të jetë në gjendje të funksionojë në mënyrën e duhur. Duke pasur një numër të madh partish të vogla në një organ përfaqësues mund të dëmtohet seriozisht aftësia e këtij organi për të vepruar. Zgjedhjet synojnë jo vetëm të krijojnë organe përfaqësuese, por edhe që ato të jenë funksionale. Gjykata çmon se detyra e saj është të analizojë e përcaktojë nëse rregullat që vendosen e zbatohen në zgjedhjet parlamentare synojnë të përjashtojnë disa persona ose grupe personash nga pjesëmarrja në jetën politike të vendit dhe nëse problemet e krijuara nga një sistem elektoral i veçantë mund të jenë rezultat i arbitraritetit ose abuzivizmit, ose nëse sistemi është i prirur drejt favorizimit të një partie politike apo kandidati, duke i dhënë epërsi elektorale krahasuar me të tjerët.

62. Gjykata vëren se Raporti i datës 2.10.2020 i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për dy projektligjet, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, shprehet se: “Ndryshimi në nenin 162 të Kodit parashikon uljen e pragut për ndarjen e mandateve

nga 3 në 1%. Ky ndryshim, i cili u bë sipas kërkesës së opozitës parlamentare, parashikon se, që të përfshihet në formulën e ndarjes së mandateve në zonën përkatëse zgjedhore, një subjekt zgjedhor (parti/koalicion/kandidat i pavarur) duhet të ketë grumbulluar së paku 1% të totalit të votave të vlefshme në rang kombëtar. Ky konsiderohet një prag natyral pasi është i përafërt me numrin e votave që i takojnë një mandati deputeti.”. Edhe sipas përfaqësueses së Kuvendit, synimi i nivelit 1% ka qenë inkurajimi i partive të vogla që të marrin pjesë në procesin zgjedhor dhe të kenë mundësi të bëhen pjesë e Kuvendit.

63. Gjykata konstaton se ky raport nuk ka trajtuar kandidatët e propozuar nga zgjedhësit si subjekte zgjedhore dhe nuk përmban asnjë argument lidhur me efektet e këtij legjislacioni për këtë kategori subjektesh zgjedhore, ose për arsyet e trajtimit të barabartë mes tyre dhe partive politike. Në vështrim të Gjykatës, mosmarrja parasysh gjatë procesit të ligjbërjes e kandidatit të pavarur si subjekt zgjedhor kushtetues dhe e standardeve kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtën për t’u zgjedhur dhe parimin e mosdiskriminimit, e përforcon argumentin për mospërligjien e masës së pragut 1%, si një prag që e bën kandidimin dhe të drejtën për t’u zgjedhur joefektive.

64. Edhe sipas Opinionit të Përbashkët të datës 11.12.2020, të Komisionit të Venecias dhe OSBE/ODIHR, “Për ndryshimet kushtetuese të datës 30 korrik 2020 dhe Kodit Zgjedhor të datës 5 tetor 2020” (CDL-AD(2020)036), zëvendësimi i pragut rajonal nga 3% (për partitë) ose 5% (për koalicionet) me prag kombëtar 1% nuk solli ndryshim thelbësor. Edhe ky prag i ri do të jetë joefektiv për shkak të pragut natyral, i cili varet nga madhësia e zonave zgjedhore, ndonëse mund të jetë në favor të kandidatëve individualë dhe partive që përfaqësojnë pakicat kombëtare (*shih paragrafin 23 të Opinionit*). Ndërsa në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare të datës 25.4.2021 është vlerësuar se sistemi i përfaqësimit proporcional rajonal lejon konkurrimin e kandidatëve të pavarur, por nuk u garanton atyre mundësi të barabarta krahasuar me kandidatët e partive politike, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e OSBE-së (*shih faqen 2 të Raportit në gjuhën shqipe*). Zbatimi i pragut kombëtar për kandidatët e pavarur mund të bëjë që ata të kenë nevojë për një numër ndjeshëm më të lartë votash për të hyrë në



parlament sesa numri i votave që u duhet kandidatëve të partive në zonat përkatëse, çka vë në pikëpyetje parimin e konkurrencës në kushte të barabarta. Për këtë arsye Raporti sugjeron, ndër të tjera, rishikimin e pragut kombëtar për kandidatët e pavarur në kuadër të respektimit të së drejtës për shanse të barabarta (*shih faqet 7, 8 dhe 31 të Raportit në gjuhën shqipe*).

65. Gjykata, gjithashtu, vëren se edhe pse zgjedhja e një sistemi elektoral është vendim sovran i shtetit përmes sistemit të tij politik, në miratimin e rregullave për zbatimin e këtij sistemi merr rëndësi respektimi i standardeve dhe primeve kushtetuese që garantojnë votën universale, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë. Kjo është arsyeja kryesore që dikton nevojën e mbikëqyrjes së kuadrit ligjor zgjedhor nga Gjykata Kushtetuese.

66. Për sa më sipër, si edhe në analizë të rrethanave faktike dhe ligjore, Gjykata vlerëson se shenja e barazimit që dispozita e kundërshtuar e nenit 162, pika 1, të ligjit zgjedhor ka vënë në trajtimin e subjekteve zgjedhore mbart efekte diskriminuese për një kategori të veçantë, konkretisht kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Gjykata nuk vë në dyshim se qëllimi i ligjvënësimit në miratimin e këtyre dispozitave ka qenë trajtimi i barabartë i votave dhe i mundësive për subjektet zgjedhore, por ajo çmon se në hartimin dhe miratimin e këtyre normave ai nuk ka mbajtur parasysh dhe nuk ka vlerësuar dallimet thelbësore mes këtyre kategorive, të cilat ndikojnë edhe në rezultatet në zgjedhje. Nga pikëpamja kushtetuese këto rregullime ligjore nuk mund të justifikohen as nga konsideratat se përfaqësimi në parlament vetëm i subjekteve zgjedhore që kalojnë një prag zgjedhor është i mjaftueshëm për t'i dhënë legjitimitet parlamentit.

67. Gjykata vëren se diskriminimi mund të vijë prej disa shkaqeve, që veprojnë veçmas ose ndërveprojnë me njëra-tjetrën njëkohësisht. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, shkakut kushtetues i diskriminimit, në kuptim të nenit 18 të Kushtetutës, është ai i “bindjeve politike” të subjektit zgjedhor “kandidati i propozuar nga zgjedhësit”. Ajo shton se nocioni *bindje politike* përfshin jo vetëm shprehjen e pikëpamjeve politike dhe pjesëmarrjen në debatin politik apo inkudrimin, organizimin kolektivisht ose pjesëmarrjen në organizata apo parti politike, por edhe të drejtën për të pasur ide ose pikëpamje që

nuk bëjnë pjesë në ndonjë platformë apo program të partive politike, si dhe të drejtën për të mos iu bashkuar strukturave të organizatave ose partive politike. Në këtë kuptim, trajtimi i njëjtë nga pjesa e dispozitës ligjore të kundërshtuar i subjekteve që ndodhen në situata faktike të ndryshme për shkak të bindjeve politike, përbën diskriminim të padrejtë, për të cilin, ashtu siç u arsyetua më lart në këtë vendim, nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

68. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pjesa e fjalisë së dytë të pikës 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor, që vendos për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit kufizim të njëjtë për prapë zgjedhor me atë të kandidatëve të propozuar nga partitë politike ose nga koalicion partish politike, cenon të drejtën kushtetuese për t'u zgjedhur, në lidhje me parimin e barazisë në ligj dhe mosdiskriminimit, prandaj kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Elton Debreshi është pjesërisht e bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “p” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 49, pika 3, shkronja “e”, 71/a, 71/b, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të fjalisë së dytë të pikës 1, të nenit 162, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, në pjesën që barazon kandidatët e propozuar nga zgjedhësit me kandidatët e propozuar nga partitë politike ose nga koalicion partish politike.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 4.10.2021.

Shpallur më 28.10.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Përparim Kalo, Sonila Bejtja



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesat nr. 13514/16 dhe 52735/20

SOKOL SHETI KUNDËR SHQIPËRISË DHE MERITA GJASHTA KUNDËR SHQIPËRISË (*Shih tabelën bashkëngjitur*)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 23 shtator 2021, si një Komision, i përbërë nga:

Dmitry Dedov, *kryetar*

Peeter Roosma,

Andreas Zünd, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit,

Në lidhje me kërkesat e mësipërme paraqitur në data të ndryshme, të reflektuara në tabelën bashkëlidhur,

Në lidhje me deklaratat formale për pranimin e një zgjidhjeje miqësore për çështjet,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkesave është paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Ankesat e kërkesave, në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve vendëse, iu komunikuan Qeverisë Shqiptare (“Qeveria”). Ankesat, mbështetur në të njëjtat fakte, u komunikuan edhe sipas parashikimeve të tjera të Konventës (shih tabelën bashkëlidhur).

Gjykata mori deklaratat për zgjidhje miqësore, nënshkruar nga palët, sipas së cilave kërkesit binin dakord të hiqnin dorë nga pretendime të tjera kundrejt Shqipërisë për sa u përket fakteve që sollën këto kërkesa, pas një sipërmarrjeje nga Qeveria për t’i paguar atyre shumat e detajuara në tabelën bashkëlidhur. Këto shuma do të

konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe do të paguhen brenda tre muajsh nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast se këto shuma nuk paguhen brenda periudhës së sipërpërmendur tremujore, Qeveria ndërmerr të paguajë interesin e thjeshtë kundrejt tyre, nga momenti i përfundimit të asaj periudhe deri në kompensim, në normën e barabartë me normën marginale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit plus tri pikë përqindjeje. Gjithashtu, Qeveria ndërmerr të garantojë zbatimin e vendimeve vendëse në fjalë për çështjet konkrete (shih tabelën bashkëngjitur) brenda së njëjtës periudhe tremujore, si edhe të paguajë çdo kosto për procedimet vendëse të ekzekutimit.

Pagesa dhe ekzekutimi i vendimeve vendëse për çështjet në fjalë do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

LIGJI

Duke pasur në konsideratë lëndën e njëjtë të kërkesave, Gjykata e konsideron të përshtatshme që t’i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo mbështet faktin se zgjidhja respekton të drejtat e njeriut, sipas parashikimit të Konventës dhe të protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye të justifikojë vijimin e shqyrtimit të kërkesave.

Për sa më sipër, është me vend që çështjet të përjashtohen nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos t’i bashkojë kërkesat;

Vendos t’i përjashtojë kërkesat nga lista e çështjeve, sipas nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 14 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE
E PËRKOHSHE

Dmitry Dedov
KRYETAR



SHTOJCË
LISTA E KËRKESAVE QË NGRENË ANKESA NË MBËSHTETJE TË NENIT 6§1 TË KONVENTËS
(Moszbatimi i ekzekutimit të vonuar të vendimeve vendëse)

Nr.	Kërkesa nr. data e paraqitjes	Emri i kërkuessit Viti i lindjes	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar	Vendimi përkatës vendës	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së deklaratës së ankuesit	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar për kërkuess (në euro) ¹
1	13514/16 5.3.2016	Sokol SHETI 1956	Neni 13 – mungesa e mjetit efikas në ligjin vendës në lidhje me moszbatimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse. Prot. 1 Neni 1 – ndërhyrje në gëzimin e paqtë të zotërimeve si rezultat i moszbatimit të vendimit në favor të kërkuessit	Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 3670 i datës 3.11.2015	22.7.2021	15.7.2021	2,500
2	60743/16 6.10.2016	Merita GJASHTA 1958	Neni 13 – mungesa e mjetit efikas në ligjin vendës për moszbatimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse.	Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 01524/13, i datës 7.4.2016	22.7.2021	17.5.2021	2,100

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuessve.



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 26512/12

ILIR BEQJA KUNDËR SHQIPËRISË

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 23 shtator 2021, si një Komision i përbërë nga:

Dmitry Dedov, *kryetar*,

Peeter Roosma,

Andres Zünd, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit*,

Për sa i përket kërkesës së mësipërme dorëzuar në datë 5 prill 2012,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Kërkuesi, z. Ilir Beqja, ka lindur në Tiranë.

Kërkuesi u përfaqësua nga z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë.

Ankesa e kërkuesit për një shkelje të nenit 3 të protokollit nr. 1 të Konventës, për shkak të diskualifikimit të tij për mbajtjen e mandatit parlamentar, iu komunikua Qeverisë Shqiptare (“Qeveria”).

Me anë të shkresave të datës 20 nëntor dhe 15 dhjetor 2020, vërejtjet e Qeverisë me shkrim, në shqip dhe në anglisht, iu dërguan përfaqësuesit të kërkuesit, me anë të Shërbimit të Komunikimeve Elektronike të Gjykatës (*eComms*), i cili u ftua që deri më 4 janar 2021 të paraqiste me shkrim çdo vërejtje që dëshironte të bënte si përgjigje në emër të kërkuesit, së bashku me pretendimet për kompensim të drejtë. Nuk është dërguar asnjë përgjigje, edhe pse përfaqësuesi i kërkuesit i shkarkoi shkresat më 7 dhjetor 2020, dhe 5 janar 2021, respektivisht.

Me anë të një shkrese të datës 4 shkurt 2021, përfaqësuesi i kërkuesit u bë me dije se mosdorëzimi i një përgjigjeje mund të rezultonte në përjashtimin e kërkesës sipas nenit 37§1 (a) të Konventës. Përfaqësuesi i kërkuesit e shkarkoi shkresën më 8 shkurt 2021, dhe më pas më 11 shkurt, 17 maj, 8 qershor dhe 29 korrik 2021.

Megjithatë, nuk erdhi asnjë përgjigje. Ai nuk ka kërkuar të kontaktojë Gjykatën për të raportuar për ndonjë çështje teknike, ose për ndonjë çështje tjetër.

LIGJI

Për sa më sipër, dhe në mungesë të rrethanave të veçanta në lidhje me respektimin e të drejtave të garantuara nga Konventa dhe Protokollet në të, Gjykata, në mbështetje të nenit 37§1(a) të Konventës, gjykon se nuk justifikohet që të vijohet më tej me shqyrtimin e kërkesës,

Për këtë arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 14 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSSEKRETARE
E PËRKOHSHME

Dmitry Dedov
KRYETAR

VENDIM

Nr. 207, datë 8.10.2021

MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “VOLTALIA” SA DHE OST SHA, PËR VLERËSIMIN DHE PRANIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË MARRËVESHJEN STANDARDE TË LIDHJES, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 87, DATË 20.4.2018

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, pika “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 129/5 prot., datë 6.10.2021 nga drejtoritë teknike, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Votalia” s.a. dhe OST sh.a., “Për vlerësimin dhe pranimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen standarde të lidhjes, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018”,

konstatoi se:

Shoqëria “Votalia” s.a., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 745/6 prot., datë



11.6.2021, ka paraqitur kërkesën për vlerësimin dhe pranimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen standarde të lidhjes të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, “Mbi miratimin e rregullores së procedurave, për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, si dhe marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”.

ERE, nëpërmjet shkresës nr. 745/3 prot., datë 23.6.2021, dërguar OST sh.a., i ka kërkuar OST sh.a., të shprehë qëndrimin e saj lidhur me propozimet e kërkuara përpara shqyrtimit të kërkesës nga ana e jonë.

Shoqëritë “Votalia” s.a., dhe OST sh.a., nëpërmjet shkresës së përbashkët të protokolluar në ERE me nr. 745/6 prot., datë 13.9.2021, kanë paraqitur marrëveshjen e lidhjes, të rakorduar nga palët, duke parashtruar, se palët kanë rënë dakord për kushtet dhe afatet e marrëveshjes së lidhjes.

Palët kanë bërë me dije se marrëveshja e propozuar ndryshon nga modeli i Marrëveshjes së Lidhjes të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, “Mbi miratimin e rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit; marrëveshjes së operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, si dhe marrëveshjes së lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit”.

- Në momentin e miratimit të Marrëveshjes së lidhjes në Rrjetin e Transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, nuk ka pasur asnjë impiant fotovoltaiik të lidhur apo kërkesë për lidhje nga impiante të tillë, me sistemin e transmetimit të energjisë elektrike. Kjo evidentohet dhe në faktin se në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, në nenin 1 “Anekset dhe përkufizimet”, jepet përkufizimi i termit “impiant”, si vijon: “Impiant” (në rastin e marrëveshjeve të lidhjes me impiant gjenerimi) nënkupton hidrocentralin, që do të ndërtohet nga përdoruesi”.

- Impiantet gjeneruese të energjisë elektrike kanë karakteristikat e tyre, në këtë kontekst edhe impiantet fotovoltaiike të gjenerimit të energjisë elektrike kanë veçoritë e tyre dhe ndryshojnë nga

impiantet hidrike (hidrocentralet). Për rrjedhojë, marrja në konsideratë e këtyre karakteristikave edhe në marrëveshjet përkatëse përfshi edhe Marrëveshjen e lidhjes në rrjet është e domosdoshme. Siguria e operimit të rrjetit është një element që duhet të merret në konsideratë në planifikimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit, në rastet e lidhjes së impianteve fotovoltaiike me sisteme konvertimi, elemente që janë marrë parasysh në përpilimin e kësaj marrëveshjeje.

- Shoqëria “Votalia” s.a. dhe OST sh.a., nëpërmjet shkresës së përbashkët të protokolluar në ERE me nr. 745 prot., datë 11.6.2021, deklaroi se palët kanë rënë dakord që “Karavasta Solar” sh.p.k. do të kryejë punimet, me kostot e veta, për ndërtimin e një linje transmetimi 220 kV, përfshirë traktin përkatës 220 kV në nënstacionin Fier, për lidhjen e centralit fotovoltaiik me rrjetin e transmetimit të OST-së.

- Ky përcaktim është në përputhje me “Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018, në pikën 4.5.1, të kësaj rregulloreje është e sanksionuar qartë, se: “Në të gjitha rastet, kostot për lidhjen ose modifikimin e saj me rrjetin e transmetimit përballohen nga aplikuesi”.

- Në të njëjtën kohë, në nenin 10, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet, se: “ERE bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe me institucionet e tjera publike, për sa u takon çështjeve objekt të këtij ligji që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre”.

- Nisur nga gjithë sa parashtrohet më sipër vlerësohet se është e rëndësishme që të krijohen kushtet e nevojshme për zhvillimin dhe diversifikimin e burimeve të rinovueshme të energjisë edhe në aspektin e marrëveshjeve, që mundësojnë lidhjen me rrjetin dhe sigurinë e operimit të rrjetit dhe të impianteve gjeneruese, që reflektojnë karakteristikat dhe veçoritë e tyre, me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe për burimet gjeneruese fotovoltaiike.

- Neni 20, pika “h”, e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, të ndryshuar, përcakton se: “ERE miraton kontratën tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e



rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik”.

- Në këto rrethana, marrëveshja duhet të shërbejë si një marrëveshje që përcakton kushtet e përgjithshme, duke marrë në konsideratë sa parashtrohet nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me shkresën nr. 5038/1 prot., datë 12.7.2021, respektivisht:

I. Projekti të jetë zgjedhur bazuar në një proces konkurrimi.

II. Fuqia e instaluar e Impiantit të jetë nga 100 mw e lartë.

III. Çmimi i nxjerrë nga procesi konkurrues është nën 30 euro/mwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e Marrëveshjes së lidhjes me rrjetin e transmetimit ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit OST sh.a. dhe “Votalia” s.a., përcjellë me shkresën me nr. 5430 prot., dt. 13.9.2021 të OST sh.a. (bashkëlidhur).

2. Marrëveshja e lidhjes shërben për projektet, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

i. janë zgjedhur bazuar në një proces konkurrimi;

ii. fuqia e instaluar është nga 100 mw e lartë;

iii. çmimi i shitblerjes së energjisë elektrike, që rezulton nga procesi konkurrues është nën 30 euro/mwh.

3. Kjo marrëveshje ndërmjet “Votalia” s.a. dhe OST sh.a. është e vlefshme për sa kohë që respektohen kushtet e mësipërme.

4. Të ngarkohet OST sh.a., në cilësinë e të licencuarit, për të hartuar marrëveshjen e lidhjes në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit, për projekte të ngjashme.

5. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 208, datë 8.10.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES, MBI MASAT E TË LICENCUARVE NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT ME ENERGJI, PËR ARRITJEN E TREGUESVE TË MATJES DHE TË VLERËSIMIT NGA ERE TË PERFORMANCËS SË SHËRBIMIT NDAJ KLIENTIT

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, 16 dhe 20, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 6, pika 3, 16, pika 18, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 129/2 prot., datë 6.10.2021 të Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores, mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit, për arritjen e treguesve të matjes dhe të vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”,

konstatoi se:

- Në pikën 4.2, të objektivave strategjike të ERE-s, për periudhën 2021–2023, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 74/2021, është parashikuar se: “ERE do të përgatisë treguesit e matjes dhe të vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim”.

- Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar “Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2020”, ku mes të tjerave ka përcaktuar detyrat e ERE-s për zbatim gjatë vitit 2021.

- Në pikën 5, të rezolutës është parashikuar se: “ERE duhet të punojë për hartimin e treguesit të matjes dhe të vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit që garanton çdo i licencuar për furnizim, për të bërë të mundur ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me standarde për konsumatorin.”.



- Në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar, ERE ka të drejtën dhe detyrën për të monitoruar, kontrolluar dhe inspektuar shërbimet e operatorëve të licencuar, në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore, si dhe zbatimin e vendimeve dhe urdhreve të ERE-s.

- Kjo rregullore synon të adresojë masat që të licencuarit në aktivitetin e furnizimit duhet të marrin, me qëllim garantimin e një shërbimi konsumator cilësor, por edhe hapat që duhet të ndjekin, me qëllim garantimin e sa më sipër, nëpërmjet informimit, sigurimit të mjeteve të brendshme menaxheriale, me qëllim adresimin e ankesave, investimeve në burime njerëzore kompetente dhe të mjaftueshme apo garantimit të aksesit të ERE-s në mbikëqyrjen e përmbushjes së këtyre treguesve, sipas periodave të parashikuara në këtë rregullore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores mbi masat e të licencuarve në aktivitetin e furnizimit me energji për arritjen e treguesve të matjes dhe të vlerësimit nga ERE të performancës së shërbimit ndaj klientit”.

2. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare për të licencuarit në sektorin e gazit natyror.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 209, datë 8.10.2021

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “TERFOJA”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 129/3 prot., datë 6.10.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘HEC Terfoja’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga ‘HEC Terfoja’, me kapacitet të instaluar 1980 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879 prot., datë 11.8.2021, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 175, datë 23.8.2021, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për arsye se shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. nuk kishte kryer pagesën e aplikimit.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka njoftuar shoqërinë me shkresën nr. 879/1 prot., datë 31.8.2021, dhe i ka bërë me dije se në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, mund të



paraqesë një aplikim të ri brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur edhe pagesën e aplikimit për licencim.

- Në përgjigje të njoftimit të ERE-s, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879/2 prot., datë 1.10.2021, ka dokumentuar kryerjen e pagesës së aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike".

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "HEC Terfoja" sh.p.k., rezulton se ka mungesa të theksuara në dokumentacion, në lidhje me kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim: neni 9, pika 1, gjerat "a", "b" dhe "c", plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor: neni 9, pika 2, gjerat "f" dhe "g", plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal: neni 9, pika 3, gjerat "b" dhe "d", plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC: neni 9, pika 4.1.1, plotësuar pjesërisht;

- të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin: neni 9, pika 4.1.2, plotësuar pjesërisht;

- dokumentacioni teknik dhe grafik: neni 9, pika 4.1.3, gjerat "a", "b" dhe "c", "d", plotësuar;

- dokumentacioni tekniko-ekonomik: neni 9, pika 4.1.4, gjerat "a", "b" dhe "c", "d", plotësuar;

- leje nga institucione të tjera: neni 9, pika 4.1.5., gjerat "b", plotësuar.

- Dokumentacioni i munguar ka të bëjë, me:

- Neni 9, pika 2, "Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor";

- gjerat "a"/"b" (Akti i themelimit/statuti): plotësuar pjesërisht. Shoqëria "HEC Terfoja" sh.p.k. nuk ka depozituar aktin e themelimit të saj në ERE;

- gjerat "c" (Vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB): plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE ekstraktin historik të saj me datë të përditësuar në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores dhe certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së;

- gjerat "d" (Vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë): plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka depozituar në ERE vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë me data të përditësuara dhe, gjithashtu, edhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës për vetë shoqërinë "HEC Terfoja" sh.p.k., si dhe për administratorin tjetër të shoqërisë;

- gjerat "e" (Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse): pa plotësuar. Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE strukturën e organizmit të saj.

- Neni 9, pika 3, "Dokumentacioni financiar dhe fiskal":

- gjerat "a" (Vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe të detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore): plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës me datë të përditësuar (ky vërtetim mban datë të hershme në kundërshtim me parashikimin e nenit 8, pika 3, të rregullores) dhe nuk ka paraqitur vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- gjerat "c" (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera etj.): pa plotësuar. Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores.

- Neni 9, pika 4.1, "Dokumentacioni teknik për HEC":

- neni 9, pika 4.1.1, "Të dhëna për centralin prodhues "Tërfoje": plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka paraqitur të dhënat për kapacitetin ujëmbledhës, gjatësinë e kanalit të derivacionit, tensioni në dalje të generatorit dhe datën e fillimit të operimit;



- neni 9, pika 4.1.2, “Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin: plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka paraqitur të dhënat e munguara, në lidhje me kapacitetin në MVA dhe skemën e lidhjes së përshtjellave;

- neni 9, pika 4.1.4 germa “e”, “Miratimi i projektit të zbatimit nga MIE”: pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur miratimin përfundimtar të projektit të HEC “Tërfoje” nga MIE.

- neni 9, pika 4.1.5, “Leje nga institucione të tjera”:

- germa “a”, “Miratimi i pikës së lidhjes me sistemin”: PA plotësuar. Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., nuk ka miratimin e pikës së lidhjes me sistemin e shpërndarjes.

- germa “c”: “leja mjedisore”: plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka përcjellë në ERE një VNM paraprake, që mban datë të hershme (data 9.12.2016) dhe nuk ka shpjeguar nëse kjo VNM është e vlefshme edhe për këtë aplikim, duke marrë në konsideratë faktin që ajo është lëshuar para nënshkrimit të kontratës me MIE-n, në datën 30.5.2018 dhe në kushtet e saj ndër të tjera citohet, se: “Mosfillimi i aktivitetit brenda një periudhe dyvjeçare sjell pasojë pavlefshmërinë e vendimit për ushtrimin e këtij aktiviteti. Shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka filluar punimet për ndërtimin e HEC-it apo fazën në të cilën ndodhet, në mënyrë që ERE të llogarisë vlefshmërinë e VNM-së paraprake.

- Nëse shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. paraqet një aplikim të ri, në respektim të kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, në zbatim nenit 10, pika 7, të po kësaj rregulloreje edhe pagesa për aplikim do të konsiderohet e vlefshme për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Tërfoje”, me kapacitet të instaluar 1980 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 210, datë 8.10.2021

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC TERFOJA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”; të nenit 5, pika 1, germa “e” dhe të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 129/4 prot., datë 6.10.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘HEC Terfoja’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879 prot., datë 11.8.2021, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 176, datë 23.8.2021, vendosi të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për arsye të moskryerjes së pagesës së aplikimit.



- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE ka njoftuar shoqërinë me shkresën nr. 879/1 prot., datë 31.8.2021, dhe i ka bërë me dije se, në mbështetje të parashikimit të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, mund të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës, për shqyrtimin e aplikimit, dhe dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur edhe pagesën e aplikimit për licencim.

- Në përgjigje të njoftimit të ERE-s, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 879/2 prot., datë 1.10.2021, ka dokumentuar kryerjen e pagesës së aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit, në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., rezulton se ka mungesa të theksuara në dokumentacion, në lidhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “b”, “d”, plotësuar;

- Dokumentacioni i munguar ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- germat: “a”/“b” (akti i themelimit/statuti), plotësuar pjesërisht. Shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k., nuk ka depozituar aktin e themelimit të saj në ERE;

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB), plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka depozituar në ERE ekstraktin historik të saj me datë të përditësuar, në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, si dhe certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së;

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka depozituar në ERE vërtetimet e gjykatës dhe të prokurorisë me data të përditësuara, dhe gjithashtu edhe vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës për vetë shoqërinë “HEC Terfoja” sh.p.k., si dhe për administratorin tjetër të shoqërisë;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), pa plotësuar. Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE strukturën e organizmit të saj;

Nenin 9, pika 3, dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka paraqitur vërtetimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Kukës me datë të përditësuar (ky vërtetim mban datë të hershme në kundërshtim me parashikimin e nenit 8, pika 3, të rregullores) dhe nuk ka paraqitur vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.), pa plotësuar. Shoqëria nuk ka depozituar asnjë dokument në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;

Nenin 9, pika 4.8, dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike:

- germat: “a”/“d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në gWh/sipas viteve), pa plotësuar. Shoqëria nuk ka paraqitur sa kërkohet nga kjo pikë e rregullores;

- germa “b” (kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti), plotësuar pjesërisht. Shoqëria nuk ka specifikuar kapitalin që do të vinte në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike;

- germa “c” (lista e kontratave të mëparshme, nëse ka pasur), pa plotësuar. Shoqëria nuk ka ushtruar më parë veprimtari në fushën e energjisë dhe si e tillë nuk mund të disponojë kontrata të realizuara më herët. Megjithatë duhet të bënte



plotësimin e kësaj kërkesë të rregullores në formë deklarative, sikurse vijohet nga subjektet të cilët nuk e kanë ushtruar ndonjëherë këtë veprimtari.

- Nëse shoqëria “HEC Terfoja” sh.p.k. paraqet një aplikim të ri, në respektim të kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, në zbatim të nenit 10, pika 7, të po kësaj rregulloreje, edhe pagesa për aplikim do të konsiderohet e vlefshme për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “HEC Terfoja” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 211, datë 8.10.2021

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR HEQJEN E LICENCËS ME NR. 85, SERIA PV09K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “PURE ENERGY STEBLEVA” SHPK, ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 61, DATË 19.8.2009

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 95 dhe të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; të nenit 7, 8 dhe 9,

të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 129/1 prot., datë 6.10.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.9.2021, ‘Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 85, seria PV09K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Pure Energy Stebleva’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.8.2009”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 10.9.2021, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 85, seria PV09K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Pure Energy Stebleva” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.8.2009.

- Vendimi i mësipërm u mor për arsye se shoqëria “Pure Energy Stebleva” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat, ndaj ERE-s, pagesën rregullatore të vitit 2020, për licencën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 951 prot., datë 15.9.2021, shoqëria është njoftuar për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187/2021, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE, në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se shoqëria i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.

- Në nenin 8, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet se: “Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari, sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30



ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin, mbi argumentet e paraqitura dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t'i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës, në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat: “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje”.

- Në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të dispozitës së mësipërme, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria “Pure Energy Stebleva” sh.p.k.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura fakton ndryshimin e statusit të subjektit, të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut, që çoi marrjen e masës për fillimin e procedurës, për heqjen e licencës.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet se: “Me marrjen e informacionit të detajuar, me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës nr. 85, seria PV09K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Pure Energy Stebleva” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.8.2009.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.9.2021, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 85, seria PV09K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Pure Energy Stebleva’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 19.8.2009”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 212, datë 8.10.2021

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT “DEPA COMMERCIAL” SA PËR APLIKIM NË TAP AG, PËR FAZËN JO TË DETYRUESHME NË TREG - TESTI I TAP AG, PËR KAPACITETIN DHE LIDHJEN

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 13; 15, pika 1, germa “a”; 16, pika 24, 25; 17, pika 4; 19, pika 5 dhe të nenit 108, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të vendimit nr. 122, datë 11.5.2021, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e propozimit të projektit TAP, SRG dhe DESFA, për procesin e rritjes së kapacitetit, për vitin 2019”; të seksionit 4.7, pika 9, të “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë”, korrik 2013; të opinionit 1/2013, të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 maj 2013, “Mbi përjashtimin e ndërlidhësit TAP AG nga kërkesa të caktuara, sipas direktivës 2009/73/EC, nga Autoriteti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 8.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 129/6 prot., datë 6.10.2021 nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi “Miratimin e kërkesës së subjektit “Depa Commercial” s.a., për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG”,



konstatoi se:

- “Depa Commercial” s.a. paraqiti në ERE “Kërkesën për aplikim nga “Depa Commercial” s.a.për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG, në përputhje me nenin 4.7, pika 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, dhe direktivën 2003/55/EC, e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 26 janar 2003, lidhur me rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të gazit natyror.

- TAP AG, sipas neneve 4.1, pika 7 dhe 4.7, pika 2, 6 dhe 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, është e detyruar të plotësojë kërkesat për kapacitetin detyrues/lidhës të cilat rezultojnë nga çdo testim tregu.

- Referuar njoftimit të fazës jodetyruese për testin e tregut TAP AG 2021, kërkesat nga palët e interesuara për lidhjet/kapacitetet jodetyruese duhet të paraqiten në TAP AG deri më datë 11 tetor 2021.

- Faza jodetyruese e testimit të tregut, për vitin 2021, nga Gazsjellësi Trans Adriatik ka filluar në 12 korrik 2021. Testi i tregut duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e miratuara bashkërisht me autoritetet rregullatore italiane (ARERA), greke (RAE) dhe shqiptare (ERE);

- “Depa Commercial” s.a. shprehet se është në fazën paraprake jo të detyrueshme të përcjelljes së aplikimit/kërkesës për fazën jo të detyrueshme, për lidhjen dhe kapacitetin e gazit natyror pranë shoqërisë TAP AG.

- Kërkesa për aplikim nga “Depa Commercial” s.a.është në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, si të përcaktuara në paragrafin 4.7 të tij, njoftimin e fazës jodetyruese për testin e tregut TAP AG 2021, në përputhje me udhëzimet për testin e tregut të 2021-shit, të Gazsjellësit Trans Adriatik, “Kodin e rregullat për mekanizmat e alokimit të kapacitetit”, legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit, ERE nuk ka kundërshtime për këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Kërkesën e subjektit “Depa Commercial” s.a. për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë